

## **Mësim me zgjedhje**

Rajmonda Kurshumlia, Shkëndije Bokshi Nagavci, Valdete Bicurri

**Libri i mësimdhënëses/mësimdhënësit**

**Projekte për të lexuarit me kuptim**

**Lexim-kuptimi dhe të zhvilluarit  
e mendimit kritik**

**5**

Njësia mësimore: **Qarkullimi i ujit në natyrë**

Ora e parë: Shfrytëzo njohuritë paraprake

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Tregon informacionet që ka për qarkullimin e ujit në natyrë.

**Unë bëj**

Udhëzohen nxënëset/it të shikojnë me vëmendje ilustrimin e qarkullimit të ujit në natyrë.

**Ne bëjmë**

Hapet debat me pyetjet:

- Çfarë vëreni në figurë?
- Çfarë dini për ujin?

Nxënëset/it shpalosin njohuritë e tyre paraprake rreth ujit dhe lëvizjes së tij në natyrë.

**Ju bëni**

Kërkohet nga nxënëset/it t'u përgjigjen pyetjeve në tabelë, ku theks të veçantë i kushtohet përcaktimit të titullit dhe temës, bazuar në ilustrim.

Shkruhen në tabelë të gjithë titujt dhe temat e përzgjedhura nga nxënëset/it.

Nxënëset/it përcaktohen për temën dhe titullin më të qëlluar.

Pyetje e mundshme:

- Po të ishe poet, ky ilustrim do të të frymëzonte që të thurje një poezi apo një prozë; dhe pse?

Njësia mësimore: <b>Qarkullimi i ujit në natyrë</b>
Ora e dytë: Fjalori im
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore 1. Lexon vjershën “Qarkullimi i ujit në natyrë”, 2. Identifikon fjalët e panjohura në vjershë, 3. Gjen kuptimin e fjalëve të panjohura.
<b>Unë bëj/Ne bëjmë</b>
Nxënëset/it, të udhëzuar paraprakisht, sjellin në klasë nga një fjalor për secilin grup. Gjithashtu, edhe mësimdhënësi/ja duhet ta ketë një fjalor për të punuar së bashku me nxënëset/it. Jepen udhëzimet e duhura për mënyrën e përdorimit të fjalorit, duke respektuar rendin alfabetik.
<b>Ju bëni</b>
Nxënëset/it kanë për detyrë të gjejnë në fjalor kuptimin e fjalëve të panjohura nga poezia e mësuar dhe ti shkruajnë në tabelën e fjalorit. Diskutohen ato dhe krahasohen me përkthimet e tyre të hamendësuara se sa ia kanë qëlluar, sa u janë afruar dhe sa nuk e kanë pasur fare idenë se për çka bëhet fjalë.
<b>Unë bëj/Ju bëni</b>
Udhëzohen nxënëset/it që të përgjigjen në pyetjet e kuizit, përmes plotësimit të hapësirave të zbrazëta. Vlerësohen nxënëset/it.
<b>Ne bëjmë</b>
Organizohet një diskutim rreth rezultateve të arritura në kuiz. Përgjigjet e sakta janë: 1. a) arra, bleta, era, hana, xhami b) lapsi, libri, limani, luani, lumi 2. mbiemri, mbaj 3. a) udhë, udhëtar, udhëtoj, udhërrëfyes b) gjithë, gjithëkombëtar, gjithësi, gjithëpërfshirës c) bio, biologji, biosferë, biokimi 4) përrallë, përrallëtar, përrallëz, përrallis

Njësia mësimore: **Qarkullimi i ujit në natyrë**

Ora e tretë: Kreativiteti yt

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Paraqet në mënyrë vizuale përmbajtjen e vjershës.

**Unë bëj**

Udhëzohen nxënëset/it që përmes vizatimit të paraqesin përmbajtjen e vjershës.  
Kujdes! Vizatimi duhet të ketë origjinalitetin e vet.

**Ne bëjmë**

Kërkohet nga nxënëset/it që t'i diskutojnë çështjet kryesore, të cilat do t'i paraqesin me anë të vizatimit.  
Përcaktohet koha e aktivitetit - 20 min.

**Ju bëni**

Nxënëset/it paraqesin idetë e tyre në letër dhe shkëmbejnë vizatimin me shokun apo shoqen e bankës. Kërkohet nga secili që ta përshkruajë punimin e njëri-tjetrit dhe ta vlerësojë me notë apo me ndonjë simbol.

Njësia mësimore: **Qarkullimi i ujit në natyrë**

Ora e katërt: Përdor pesë shqisat

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Analizon përmbajtjen e vjershës në disa aspekte: ndjenja, pamja, tingujt.

**Unë bëj**

Udhëzohen nxënëset/it të lexojnë edhe njëherë vjershën dhe, duke vënë në shërbim shqisat e tyre, imagjinatën dhe përmbajtjen e vjershës, të përshkruajnë pamjen që u krijohet në mendjen e tyre, zërat që dëgjojnë, aromën që ndiejnë, çfarë prekin dhe çfarë mund të shijojnë.

**Ju bëni**

Nxënëset/it, individualisht, plotësojnë tabelën dhe shkëmbejnë mendimet në grup të vogël, pastaj me tërë klasën.

**Ne bëjmë**

Pyetje të mundshme:

- Si u ndiet?
- Cila është e veçanta e këtij aktiviteti?
- Më shumë do të preferojë të tregosh emocionet tuaja apo të jesh një dëgjues i mirë?

Njësia mësimore: **Qarkullimi i ujit në natyrë**

Ora e pestë: Hulumto më shumë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Hulumton për qarkullimin e ujit në natyrë.

**Unë bëj/Ju bëni**

Nxënëset/it, të udhëzuar paraprakisht që të marrin informata më të hollësishme rreth qarkullimit të ujit në natyrë, udhëzohen që t'i shkruajnë ato në rubrikën e caktuar dhe, më pas, t'i lexojnë ato para klasës.

**Ne bëjmë**

Formoni një listë në tabelë në të cilën nxënëset/it do t'i shkruajnë të gjitha të dhënat e reja rreth temës.

Organizohet një diskutim i përbashkët, ku nxënëset/it shpalosin njohuritë e reja.

Pyetje eventuale:

- A mendoni që është i domosdoshëm hulumtimi i temave?  
Nëse po, pse? Nëse jo, pse?
- Si ndikoi te ti hulumtimi dhe a do ta vësh në jetë atë?

Njësia mësimore: **Qarkullimi i ujit në natyrë**

Ora e gjashtë: Shkruaj

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Shkruan ese për qarkullimin ujit në natyrë.

**Ne bëjmë**

Informohen nxënëset/it që do të shkruajnë një ese duke përdorur 250 deri në 300 fjalë.

Si të shkruhet një ese? - është pyetja e cila duhet parashtruar për diskutim.

Shkruhen përfundimet:

1. Duhet të zgjidhet tema,
2. Të respektohet struktura e esesë:
  - a) Hyrja
  - b) Zhvillimi
  - b) Përfundimi

**Unë bëj**

Shkruhen në tabelë dy tema:

1. Qarkullimi i ujit në natyrë,
2. Unë jam një pikë uji.

Këshillohen nxënëset/it të përzgjedhin temën më të pëlqyer.

**Ju bëni**

Nxënëset/it do të kenë 30 minuta kohë për të shkruar esenë.

Korrigjohen esetë dhe vlerësohen.

Njësia mësimore: **Albert Ajnshtajn**

Ora e parë: Përmbledh njohuritë paraprake

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Tregon informacionet që ka për shkencën dhe shkencëtarët.

**Unë bëj**

Fillohet bashkëbisedimi me nxënës përmes disa pyetjeve.

Dy nga pyetjet e mundshme:

- Cilët shkencëtarë i njihni?
- Çka na ndihmon shkenca për jetën? Etj.

**Ne bëjmë**

Kërkohet nga nxënëset/it që t'i plotësojnë hapësirat e zbrazëta sipas kërkesës së dhënë.

Nxënëset/it mund të shfrytëzojnë burime të ndryshme për të plotësuar kërkesën.

Plotësimi i kërkesës mund të bëhet në dyshe.

**Ju bëni**

Lexohen disa prej punimeve të nxënësve dhe diskutohet për mënyrat e ndryshme të përgjigjeve.

Puna e nxënësve vlerësohet.



Njësia mësimore: **Albert Ajnshtajn**

Ora e dytë: Fjalori im

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Lexon tekstin,
2. Identifikon fjalët e panjohura,
3. Gjen kuptimin e fjalëve të panjohura.

**Unë bëj/Ne bëjmë**

Organizohet një aktivitet: Kush e gjen më shpejt?

Paraprakisht sigurohet që nxënëset/it të kenë fjalorin e gjuhës shqipe nëpër grupe.

Kur mësuesja/i lexon fjalën e panjohur, nxënëset/it duhet ta gjejnë atë sa më shpejt në fjalor. Grupi që e gjen numrin e saktë të faqes së fjalorit fiton një pikë. Loja vazhdon deri në fjalën e fundit.

**Ju bëni**

Udhëzohen nxënëset/it të përshkruajnë saktë kuptimin e fjalëve të panjohura si në fjalor si në rubrikën *Fjalori im*.

Diskutohen përshkrimet e mëparshme të fjalëve të reja dhe krahasohen me kuptimin e saktë sipas fjalorit.

Përzgjidhet fitues nxënësi, mendimi i të cilit ishte më i përafërti me shpjegimin e fjalorit.

Njësia mësimore: **Albert Ajnshtajn**

Ora e tretë: Biografi

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  
1. Shkruan biografinë e Albert Ajnshtajnit.

**Unë bëj /Ne bëjmë**

Udhëzohen nxënëset/it të shpalosin materialin rreth hulumtimit që kanë bërë për fëmijërinë e Albert Ajnshtajnit.

Diskutim:

- Si ishte fëmijëria e Ajnshtajnit?
- Çfarë fëmije ishte ai?
- Çfarë problemesh kishte?
- Cili ishte frymëzimi i tij?
- Çfarë roli kishte nëna e tij në zhvillimin emocional të Ajnshtajnit?
- Çfarë ndikimi kishte muzika në Ajnshtajnin?

**Unë bëj**

Udhëzohen nxënëset/it të shkruajnë biografinë e Ajnshtajnit, duke përmbledhur në pika të shkurtra faktet, sukseset dhe sfidat e fëmijërisë së tij.

**Alberti ishte fëmijë...** është fjalia me të cilën nxënëset/it udhëzohen të fillojnë përshkrimin e fëmijërisë së shkencëtarit.

**Ju bëni**

Nxënëset/it shkruajnë biografinë e Ajnshtajnit duke u kujdesur për drejtshkrimin dhe përmbledhjen e thuktë të informacioneve të mësuara.  
Secili nxënës lexon shkrimin e tij, argumenton faktet kryesore, dhe të gjitha të dhënat interesante i shkruajnë në tabelë.

Njësia mësimore: **Albert Ajnshtajn**

Ora e katërt: Hulumto dhe plotëso

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Hulumton më shumë për jetën e Albert Ajnshtajnit.

**Ne bëjmë**

Kërkohe nga nxënëset/it që në grupe të vogla të zhvillojnë diskutim rreth temës së parë dhe të nxjerrin tri dëshmi rreth Ajnshtajnit.

Organizohet aktiviteti “Pyetje-përgjigje”, ku grupi i parë prezanton tri dëshmitë e tyre, ndërsa grupi tjetër i parashtron pyetje rreth temës. Pastaj, vazhdon anasjelltas me të gjitha grupet punuese.

**Ju bëni**

- Si e ndryshoi botën ai? - është pyetja që nxënëset/it duhet të përgjigjen individualisht dhe secili/a prej tyre e interpreton atë para klasës.
- Cila është pyetja që do të dëshiroje t’ia bëje Ajnshtajnit?, - është detyra e radhës që nxënëset/it e punojnë në dyshe, ku njëri e lexon pyetjen e tjetri i përgjigjet dhe anasjelltas.

Vlerësohet puna e nxënësve.

Njësia mësimore: **Albert Ajnshtajn**

Ora e pestë: E vërtetë apo trillim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Identifikon të dhëna të sakta për jetën e Albert Ajnshtajnit.

**Unë bëj**

Shpjegohet rëndësia e temës që do të trajtohet, sepse duke u përcaktuar për “Të vërtetën” apo “Trillimin” rreth jetës dhe veprës së Ajnshtajnit, evidentohen të arriturat e nxënësve në procesin e hulumtimit.

- A ishte Albert Ajnshtajni vërtetë një student i dobët?
- A kishte vërtet probleme në të folur dhe si ndikoi busulla në arritjet e tij shkencore?
- Ndaj mitin e Ajnshtajnit nga realiteti dhe eksploro disa nga kapitujt më befasues nga historia e jetës së tij.

Janë disa nga pyetjet që krijojnë dilema dhe hezitime rreth temës; nxënëset/it duhet të gjejnë përgjigjen e saktë.

**Ju bëni**

Shpërndahen nëpër grupe etiketa me fjalët “ E vërtetë” dhe “Trillim”.

Lexohen me radhë pyetjet dhe pas çdo paragrafi nxënëset/it do të ngritin njëren etiketë, “E vërtetë” apo “Trillim”, dhe e argumentojnë përgjigjen e tyre.

Grupi me më shumë përgjigje të sakta vlerësohet.

Njësia mësimore: **Albert Ajnshtajn**

Ora e gjashtë: Pyetje

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  
1. Formulon pyetje rreth tekstit të lexuar.

**Unë bëj/Ne bëjmë**

Udhëzohen nxënëset/it të punojnë në grupe dhe secili merr përsipër nga një pyetje.  
Kërkohet që pasi ta shkruajnë përgjigjen, të përcaktojnë temën që trajtohet në pyetje si:

- Pyetja e parë flet për jetën arsimore të Ajnshtajnit,
- Pyetja e dytë flet për ndikimin e prindërve në jetën e Ajnshtajnit,
- Pyetja e tretë flet për prirjen e Ajnshtajnit për muzikën,
- Pyetja e katërt flet për zbulimet e Ajnshtajnit në fizikë,
- Pyetja e pestë flet për busullën dhe ndikimin e saj në studimin e Ajnshtajnit,
- Pyetja e gjashtë flet për rëndësinë e letrës së Ajnshtajnit dërguar presidentit Roosevelt.

**Ju bëni**

Lexohen shkrimet dhe nxënëset/it japin shpjegime dhe argumente rreth përgjigjeve.  
Nxitet debat në klasë.  
Korrigjohen gabimet eventuale dhe vlerësohen nga mësuesja/i.

Njësia mësimore: **Albert Ajnshtajn**

Ora e shtatë: Shkruaj

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Vlerëson të dhënat që e bënë Ajnshtajnin të njohur,

**Unë bëj/Ne bëjmë**

Udhëzohet që të përgatitet një pemë e mendimeve në tabelë.  
Kërkohet që nxënëset/it të lexojnë në heshtje kërkesën e detyrës.  
Pyetje e mundshme:

- Cila është arsyeja që Ajnshtajni iu ka bërë këtë pyetje?

**Ju bëni**

Këshillohen nxënëset/it të përqendrohen në dy çështjet kryesore, për të cilat mendojnë se e bëjnë Ajnshtajnin të veçantë, si dhe të shkruajnë një ese të shkurtër.  
Lexohen shkrimet, diskutohen ato, dhe të gjitha çështjet shkruhen në pemën e mendimeve.  
Udhëzohen nxënëset/it të formojnë një listë, duke i renditur idetë sipas rëndësisë.

Njësia mësimore: **Çarli Çaplini**

Ora e parë: Shfrytëzo njohuritë paraprake

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Tregon informacionet që ka për Çarli Çaplinin.

### Unë bëj/Ne bëjmë

Paraqitet fotografia e personazhit kryesor të filmave të Çarli Çaplinit, “Endacaku”.  
Hapet diskutim.

- E dini kush është personi në fotografi?
- Cili është profesioni i tij?
- Keni parë ndonjë film të Çarli Çaplinit?
- A ju kanë pëlqyer?, Pse?
- Çka kanë të veçantë filmat e tij?

### Ne bëjmë

Shikohen sekuenca të ndryshme nga filmat e Çarli Çaplinit.

- Si u ndiet?
- Çfarë mendoni tani për këtë aktor dhe filmat e tij?
- Çka e bën të veçantë atë?
- Çfarë mendoni, cilat tema i ka trajtuar Çaplini?
- Çfarë zhanri janë filmat e tij?
- Si arrin Çarli të depërtojë te shikuesi, përderisa filmat e tij janë pa zë?

### Ju bëni

Udhëzohen nxënëset/it të shkruajnë rreth Çarli Çaplinit (pamjen, veshjet, lëvizjet etj.).  
Nxënësve u jepet kohë e mjaftueshme për të punuar.  
Gjatë punës, nxënëset/it vëzhgohen dhe ndihmohen, sipas nevojës.  
Disa nga këto shkrime lexohen në klasë, si dhe diskutohen.

Njësia mësimore: <b>Çarli Çaplini</b>
Ora e dytë: Fjalori im
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Lexon tekstin për Çarli Çaplinin,</li> <li>2. Identifikon fjalët e panjohura,</li> <li>3. Gjen kuptimin e fjalëve të panjohura.</li> </ol>
<b>Unë bëj/Ne bëjmë</b>
<p>Parashtrihen disa pyetje për diskutim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Çfarë do të dëshiroje të dije më shumë për Çarli Çaplinin?</li> <li>• A mendon që përgjigjet do t'i gjesh në tekstin e radhës?</li> </ul>
<b>Ju bëni</b>
<p>Tregohet që teksti do të lexohet me paragrafë. Një nxënës e lexon paragrafin e parë, e komenton përmbajtjen dhe u parashtron pyetje shokëve dhe shoqeve rreth materialit të lexuar. Kështu vazhdohet edhe me paragrafët tjerë.</p>
<b>Ne bëjmë</b>
<p>Pyetje të mundshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Si quhet teksti që lexuat?</li> <li>• Ku dallon ky tekst nga ai i Albert Ajnshtajnit?</li> <li>• Kush ishte Endacaku?</li> <li>• A mendoni që Endacaku dhe Sharlot janë dy personazhe të ndryshme? Përgjigjen do ta gjesh në tekst, prandaj lexoje edhe një herë atë.</li> </ul>
<b>Ju bëni</b>
<p>Analiza e fjalëve të panjohura duhet të fillojë me identifikimin e tyre, vazhdon me diskutimin në klasë dhe përfundon me plotësimin e tri shtyllave të para të tabelës së fjalorit. Në fund të orës “Fjalori im” jepet detyrë shtëpie: hulumtoni më shumë për jetën e veprën e Çaplinit dhe plotësoni tabelën faqe 27.</p>



Njësia mësimore: <b>Çarli Çaplini</b>
Ora e tretë: Hulumto
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: 1. Hulumton më shumë për jetën dhe veprën e Çarli Çaplinit.
<b>Unë bëj</b>
Paraqitet në tabelë tema “Çarli Çaplini“, dhe udhëzohen nxënëset/it për plotësimin e pemës së mendimeve.
<b>Unë bëj/Ne bëjmë</b>
Nxënëset/it sjellin në klasë rezultatet e hulumtimit dhe secili nga ta plotëson pemën e mendimeve me një fakt nga jeta dhe vepra e Çarli Çaplinit. Diskutohen dhe analizohen me kujdes të gjitha të dhënat e paraqitura.
<b>Ju bëni</b>
Krijohet klima e përshtatshme për të punuar dhe nxënëset/it vazhdojnë veprimtarinë e tyre sipas kërkesave të dhëna. Nxënëset/it gjatë punës në dyshe, ndihmohen sipas nevojës.
<b>Ne bëjmë</b>
Lexohen shkrimet e nxënësve, jepen shpjegime dhe argumente rreth përgjigjeve, si dhe nxitet debat në klasë. Korrigjohen gabimet eventuale dhe vlerësohen nga mësuesja/i.

Njësia mësimore: <b>Çarli Çaplini</b>
Ora e katërt: Kuiz
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: 1. Përgjigjet në pyetje për Çarli Çaplinit,
<b>Ne bëjmë</b>
Udhëzohen nxënëset/it të kthehen te teksti, ta rilexojnë atë duke u fokusuar në të dhënat kryesore të jetës së Çarli Çaplinit.
<b>Ju bëni</b>
Udhëzohen nxënëset/it se si duhet të plotësohet kuizi, i cili përmban pyetje me alternativa (me shumë zgjedhje). Hapi 1 - Lexo me kujdes pyetjen, Hapi 2 - Qarko përgjigjet e sakta.  Nxënëset/it punojnë në mënyrë të pavarur dhe, më pas, shkëmbejnë idetë në grup të vogël.
<b>Unë bëj/Ne bëjmë</b>
Organizohet kuizi i përbashkët. Mësuesja/i lexon pyetjen, ndërsa përfaqësuesit e grupeve duhet të japin përgjigjet sa më shpejt dhe më saktë. Vlerësohen përgjigjet me poenë, të cilët caktohen paraprakisht nga mësuesja/i. Në këtë mënyrë vazhdohet me të gjitha pyetjet. Shpallet fitues grupi me më shumë poenë. Korrigjohen gabimet eventuale.

Njësia mësimore: **Çarli Çaplini**

Ora e pestë: Lexo, gjej dhe bëj përmbledhjen

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Analizon tekstin në bazë të kërkesave,
2. Identifikon informacione të detajuara në tekst.

**Unë bëj/Ne bëjmë**

Së bashku me nxënëset/it rikujtojmë të dhënat e jetës dhe veprës së Çarlit.

**Ju bëni**

Krijohet klima e përshtatshme për të punuar dhe nxënëset/it vazhdojnë veprimtarinë e tyre, sipas kërkesave të dhëna.

Të ndarë sipas numrave 1, 2 dhe 3, formojnë grupet punuese sipas numrit përkatës të detyrave; shkëmbejnë idetë dhe, përmes një përfaqësuesi, prezantojnë punën e bërë.

Nxitet debat në klasë ku secili grup i parashtron pyetje grupit prezantues, të cilët duhet të argumentojnë me fakte përgjigjet e tyre.

**Unë bëj**

Korrigjohen gabimet eventuale dhe vlerësohen nga mësuesja/i.

Njësia mësimore: <b>Çarli Çaplini</b>
Ora gjashtë: Shkruaj
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: 1. Shkruan autobiografi.
<b>Unë bëj/Ne bëjmë</b>
<p>Shtrohen pyetjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ç'është biografia?</li> <li>• Po autobiografia ç'është?</li> <li>• Te cilat tekste i keni hasur?</li> <li>• Si duhet të shkruhet një autobiografi?</li> </ul> <p>Ftohen nxënëset/it të krijojnë një diagram të Venit dhe të gjejnë të përbashkëtat dhe të veçantat e autobiografisë dhe biografisë. Lexohen disa nga shkrimet e nxënësve.</p>
<b>Unë bëj/Ju bëni</b>
<p>Këshillohen nxënëset/it të shkruajnë një autobiografi me të dhënat kryesore të jetës së tyre. Krijohet një atmosferë e këndshme pune, duke vënë në sfond një muzikë të lehtë instrumentale. Leximi i autobiografisë organizohet në karrigen e autorit. Nxënëset/it kanë të drejtë të japin sugjerime rreth jetëshkrimit të shokëve dhe shoqeve të klasës.</p>
<b>Unë bëj</b>
Vlerësohen nxënëset/it dhe këshillohen për të përmirësuar gabimet eventuale.

Njësia mësimore: <b>Çarli Çaplini</b>
Ora e shtatë: Shkruaj
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: 1. Shkruan ese argumentuese rreth temës së dhënë.
<b>Unë bëj/Ne bëjmë</b>
Shkruhet tema e ditës në tabelë. “Një ditë pa të qeshura është një ditë e humbur“, - Çarli Çaplini Nxiten nxënëset/it të diskutojnë rreth kësaj teme.
<b>Ju bëni</b>
Udhëzohen nxënëset/it të paraqesin me shkrim idetë e tyre rreth temës. Nxënësve u caktohet koha e përfundimit të shkrimit. Lexohen shkrimet e nxënësve. Vlerësohen tri shkrimet më të bukura.
<b>Ne bëjmë</b>
Zhvillohet diskutim: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pse Çarli e merr si të humbur ditën pa të qeshura?</li> <li>• Pse i jep kaq rëndësi të qeshurave?</li> <li>• A mendoni që ka të drejtë? Pse?</li> <li>• Si ndikojnë të qeshurat në jetën tuaj?</li> <li>• A mendoni që mund të ndikoni në jetën e të tjerëve me të qeshura?</li> </ul>

Njësia mësimore: <b>Çarli Çaplini</b>
Ora e tetë: Shkruaj
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: 1. Paraqet në mënyrë kreative informacionet e fituara për Çarli Çaplinit.
<b>Ne bëjmë</b>
Secili nga xënëset/it, të udhëzuar paraprakisht, do t'i interpretojnë rolet e veta: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gazetarët kanë përpiluar një gazetë muri për jetën dhe veprën e Çarli Çaplinit.</li> <li>• Aktorët do të imitojnë personazhin kryesor, "Endacakun" .</li> <li>• Piktorët do të paraqesin një poster nga filmi i Çarli Çaplinit.</li> </ul>
<b>Unë bëj/Ne bëjmë</b>
Nxënëset/it shpalosin përvojën e tyre gjatë përgatitjes së detyrës, vështirësitë dhe përparësitë e punës grupore.
<b>Ju bëni</b>
Siguroheni që nxënëset/it ta shndërrojnë klasën në skenë filmi, në galeri arti dhe në portal gazetaresk, me mjete të ndryshme, kostumografi dhe muzikë. Të gjitha grupet në performancë duhet të sinkronizohen me njëra-tjetrën.  Prezantimi duhet të bëhet para audiencës (fëmijë të klasave të tjera, mësimsdhënës/e etj). Vlerësohet angazhimi dhe performanca.

Për njësitë mësimore: **Pikaso, Viti ri dhe kostumet, Dielli**, përdoren përgatitjet e temave të mëparshme.

Njësia mësimore: <b>Ditari i Gregut</b>
Ora e parë: Shfrytëzo njohuritë paraprake
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: 1. Parashikon ngjarjen duke u bazuar në terma paraprak.
<b>Unë bëj</b>
Në tabelë shkruhen fjalët:  Ditëlindje    dhuratë    para    shokë    kursime  Kërkohet nga nxënëset/it të shkruajnë një tekst të shkurtër duke përdorur këto fjalë.
<b>Ju bëni</b>
Nxënëset/it do të plotësojnë detyrën dhe do të shkruajnë në heshtje sipas kërkesës.  Puna e nxënësve vëzhgohet nga mësuesja/i.
<b>Ju bëni</b>
Në një kënd të klasës vendosen shkrimet e nxënësve. Mësuesja kërkon nga ndonjëri prej nxënësve të zgjedh një nga shkrimet dhe ta lexojë atë, kurse të tjerët do të zbulojnë se shkrimi i cilit shok apo shoqe të klasës është. Vazhdohet kështu edhe me nxënëset/it tjerë deri në përfundim të orës.

Njësia mësimore: **Ditari i Gregut**

Ora e dytë: Fjalori im

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Lexon tekstin,
2. Identifikon fjalët e panjohura në tekst,
3. Gjen kuptimin e fjalëve të panjohura.

**Unë bëj**

Është mirë të sillni një ditar në klasë ose, në mënyrë elektronike, të shpalosni një histori të një dite në një ditar.

Do të bisedohet për mënyrën e shkrimit të ditarit duke vënë theksin në ditët, datën, pjesët e tekstit me hyrje, zhvillim e përfundim.

**Ne bëjmë**

Udhëzohen nxënëset/it të lexojnë me paragrafë, sipas kërkesave të mësueses/it.

Angazhohen disa nxënës të lexojnë.

Pasi të lexohet teksti, nxënëset/it flasin për përmbajtjen e tekstit.

**Ju bëni**

Analiza e fjalëve të panjohura duhet të fillojë me identifikimin e tyre, diskutimin në klasë dhe, në fund, plotësimin e katër shtyllave të para të tabelës së fjalorit.

Udhëzoni nxënëset/it që, për ta njohur vetë kuptimin e fjalës në kontekstin e fjalisë, teksti duhet të rilexohet sipas nevojës.



Njësia mësimore: **Ditari i Gregut**

Ora e tretë: Hulumto më shumë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Analizon tekstin e lexuar.

**Unë bëj**

Kërkohet nga nxënëset/it të rikthehen te teksti për ta lexuar.

Nxënëset/it lexojnë në heshtje për një kohë të caktuar.

**Ne bëjmë**

Udhëzohen nxënëset/it të punojnë pjesën në libër sipas kërkesës.

Aktiviteti bëhet individualisht, për një kohë të caktuar nga mësuesja/i.

**Ju bëni**

Analizohet tabela sipas mënyrës së plotësimit nga nxënëset/it dhe nxitën ata/ato për të diskutuar për çështje të caktuara.

Njësia mësimore: <b>Ditari i Gregut</b>
Ora e katërt: Kreativiteti
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: 1. Ilustron pamje nga teksti i lexuar.
<b>Unë bëj/ne bëjmë</b>
Udhëzohen nxënëset/it të rikthehen te teksti për të lexuar, por kësaj herë sipas kërkesës së caktuar. Pra, gjatë leximit, nxënëset/it mundohen të kuptojnë se cila nga pjesët e leximit u pëlqen më shumë.
<b>Ne bëjmë</b>
Udhëzohen nxënëset/it të punojnë pjesën në libër sipas kërkesës. Nxënëset/it do të vizatojnë një nga ngjarjet e pëlqyera të tekstit.
<b>Ju bëni</b>
Vizatimet e nxënësve prezantohen sipas ngjarjes së pëlqyer.

Njësia mësimore: <b>Ditari i Gregut</b>
Ora e pestë: Kutia e pyetjeve
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: 1. Përgjigjet në pyetje rreth tekstit.
<b>Unë bëj/</b>
Në klasë silllet një kuti, brenda së cilës ka pyetje të ndryshme rreth tekstit. Nxënëset/it informohen që së bashku do ta realizojnë një lojë kuizi me disa pyetje (ju mund të shtoni pyetje të tjera).
<b>Ne bëjmë</b>
Nxënëset/it e klasës ndahen në tri gupe me nga dy përfaqësues, kurse pjesa tjetër ndihmon sipas nevojës. Njëri nga nxënësit/et zbulon pyetjen për grupin, sipas radhës, dhe pritet përgjigjja e saktë për të vazhduar më grupin tjetër.
<b>Ju bëni</b>
Kuizi vazhdon deri në shpalljen e grupit fitues.

Njësia mësimore: **Projekti i Astronomisë**

Ora e parë: Shfrytëzo njohuritë paraprake

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Tregon informacione që ka mbi astronominë, yjet, planetët.

**Unë bëj**

Kërkohet nga nxënëset/it të rregullojnë shkronjat për të zbuluar fjalën.

O M S N I A T R O - ASTRONOMI

**Ju bëni**

Nxënëset/it do të plotësojnë detyrën në libër sipas kërkesës së dhënë.

Ata do të punojnë sipas një kohe të caktuar.

Puna e tyre do të jetë individuale.

**Ju bëni**

Nxënëset/it do ta lexojnë para të tjerëve plotësimin e detyrës dhe do të diskutojnë për mënyrat e ndryshme të të plotësuarit.

Vlerësohet puna e nxënësve.

Njësia mësimore: **Projekti i Astronomisë**

Ora e dytë: Fjalori im

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Lexon tekstin,
2. Identifikon fjalët e panjohura në tekst,
3. Gjen kuptimin e fjalëve të panjohura.

**Unë bëj/Ne bëjmë**

Kërkohe nga nxënëset/it të shkruajnë tri teknikat më të mira mësimore që u pëlqejnë atyre, si dhe t'i arsyetojnë ato.

Të gjitha teknikat mësimore që nxënëset/it i përmendin i shkruajmë në tabelë, dhe zgjedhim të flasim për ato (teknika) që janë përmendur më së shumti.

**Ne bëjmë**

Udhëzohen nxënëset/it të lexojnë në heshtje tekstin “Projekti i Astronomisë”.

Është mirë që të caktohet një kohë për lexim.

Pasi të lexohet teksti, nxënëset/it flasin për përmbajtjen e tekstit.

**Ju bëni**

Analiza e fjalëve të panjohura duhet të fillojë me identifikimin e tyre, diskutimin në klasë, dhe, në fund, plotësimin e katër shtyllave të para të tabelës së fjalorit.

Udhëzoni nxënëset/it që, për ta njohur vetë kuptimin e fjalës në kontekstin e fjalisë, teksti duhet të rilexohet sipas nevojës.

Njësia mësimore: **Projekti i Astronomisë**

Ora e tretë: Kreativiteti

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Vizaton yje, planetë, yjësi.

**Ne bëjmë**

Bëhet një bashkëbisedim me nxënëset/it dhe rikujtohen të gjitha planet e sistemit diellor dhe yjësitë në qiell.

Para nxënësve paraqiten yjësitë në projektor apo në ndonjë mënyrë tjetër.

**Ju bëni**

Kërkohet nga nxënëset/it të plotësojnë detyrën sipas kërkesës së dhënë.

Ata zgjedhin një yll dhe e vizatojnë atë.

Mund të përdorin mjete të ndryshme pune, si: ngjyra ndriçuese, dekore etj.

**Ne bëjmë**

Nxënëset/it i prezantojnë punimet para të tjerëve dhe tregojnë arsyen e përzgjedhjes.

Mund të nxitet edhe ndonjë diskutim rreth përzgjedhjes së yjësisve.

Njësia mësimore: **Projekti i Astronomisë**

Ora e katërt: Pyetje rreth tekstit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Përgjigjet në pyetje rreth tekstit.

**Ju bëni**

Udhëzohen nxënëset/it ta lexojnë edhe njëherë tekstin “Projekti i Astronomisë”, në heshtje, për një kohë të caktuar.

**Ju bëni**

Nxënëset/it ndahen në grupe për të punuar në formë të garës.

Për këtë veprimtari jepet një kohë e caktuar dhe garohet se cili nga grupet do të punojë më shpejt dhe më saktë.

Grupi i cili punon më së shpejti, pasi të sigurohet që i ka përgjigjet e sakta, shpallet fitues.

Për këtë krijohet një komision vlerësues.

**Ne bëjmë**

Në këtë pjesë të orës vlerësohen përgjigjet e sakta dhe shpallet grupi fitues.

Njësia mësimore: **Aladini dhe llamba magjike**

Ora e parë: Shfrytëzo njohuritë paraprake

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Tregon informacione që ka rreth përrallës Aladini dhe llamba magjike,
2. Shkëmben informacione më shokët/shoqet.

**Unë bëj**

Përgatiten disa pyetje për nxënës për të nxitur të menduarit.

Dy nga pyetjet e mundshme:

- Përmend një libër që flet për tri dëshirat?
- Si mund të plotësohen dëshirat e çuditshme?

**Ju bëni**

Udhëzohen nxënëset/it të shkruajnë për Aladinin dhe llambën magjike, duke shkëmbyer informata me shoqen/shokun e bankës. Fillimisht, ata shkruajnë fjalë që lidhen me Aladinin. Më pas, ato fjalë shfrytëzohen për të shkruar esenë.

**Ju bëni**

Disa nga këto shkrime lexohen dhe diskutohen në klasë.



Njësia mësimore: **Aladini dhe llamba magjike**

Ora e dytë: Fjalori

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Lexon tekstin,
2. Identifikon fjalët e panjohura në tekst,
3. Gjen kuptimin e fjalëve të panjohura.

**Unë bëj/Ne bëjmë**

Kërkohet nga nxënëset/it të mendojnë për tri dëshirat e tyre dhe t'i shkruajnë ato në fletore.

Nxënëset/it, këto dëshira, mund t'i lexojnë para të tjerëve.

**Ne bëjmë**

Udhëzohen nxënëset/it të lexojnë në heshtje tekstin “Aladini dhe llamba magjike”.

Është mirë që të caktohet një kohë për lexim.

Pasi të lexohet teksti, nxënëset/it duhet ta bëjnë një përshkrim të tij.

**Ju bëni**

Analiza e fjalëve të panjohura duhet të fillojë me identifikimin e tyre, diskutimin në klasë, dhe, në fund, plotësimin e katër shtyllave të para të tabelës së fjalorit.

Udhëzoni nxënëset/it që, për ta njohur vetë kuptimin e fjalës në kontekstin e fjalisë, teksti duhet të rilexohet sipas nevojës.

Njësia mësimore: **Aladini dhe llamba magjike**

Ora e tretë: Pyetje rreth tekstit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Përgjigjet në pyetje rreth tekstit.

**Unë bëj**

Udhëzohen nxënëset/it se si do të punojnë në këtë projekt mësimi.  
Puna e nxënësve mund të bëhet në dyshe, duke bashkëpunuar me njërin-tjetrin.

**Ju bëni**

Krijohet klima e përshtatshme për të punuar dhe nxënëset/it vazhdojnë veprimtarinë e tyre sipas kërkesave të dhëna.  
Nxënëset/it, gjatë punës në dyshe, ndihmohen sipas nevojës.

**Ne bëjmë**

Lexohen shkrimet e nxënësve dhe jepen shpjegime dhe argumente rreth përgjigjeve, në mënyrë që të nxitet debat në klasë.  
Korrigjohen gabimet eventuale dhe vlerësohen nga mësuesja/i.

Njësia mësimore: **Aladini dhe llamba magjike**

Ora e katërt: Kreativiteti

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Paraqet poster për filmin “Aladini dhe llamba magjike”.

**Ne bëjmë**

Me nxënës bisedojmë për përmbajtjen e tekstit “Aladini dhe llamba magjike”.  
Kujtojmë ngjarjet me interesante dhe më mbresëlënëse për tu ndërlidhur me pjesën tjetër të orës.

**Ju bëni**

Nxënëset/it ndahen në grupe, ku do të punojnë një poster sipas imagjinatës së tyre, për të shfaqur filmin “Aladini dhe llamba magjike”.  
Ata mund të përdorin mjete të ndryshme për ta realizuar posterin.

**Ne bëjmë**

Posterët e grupeve prezantohen para nxënësve të tjerë; mund të bëhet një garë për të konkurruar për posterin më të mirë.

Njësia mësimore: **Aladini dhe llamba magjike**

Ora e pestë: Imagjino dhe shkruaj

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Shkruan në bazë të imagjinatës për dëshirat që ka.

**Ne bëjmë**

Pas një përsëritjeje të shkurtër të mësimit, nxënëset/it udhëzohen se si të punojnë në pjesën tjetër të orës.

Pra, nxënëset/it do ta imagjinojnë veten në vendin e personazhit dhe do të shkruajnë në formë të monologut - nxënësi rrëfen ngjarjen.

**Ju bëni**

Krijohet një klimë e përshtatshme pune (mund të shoqërohet me një muzikë, kënga për Aladinin).

Nxënëset/it punojnë individualisht.

**Ne bëjmë**

Disa nga shkrimet e nxënësve lexohen dhe diskutohen në mes tyre.

Njësia mësimore: **Jeta e re në ishull**

Ora e parë: Shfrytëzo njohuritë paraprake

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Shkruan në bazë të imagjinatës për jetën në ishull.

**Unë bëj**

Udhëzohen nxënëset/it t'i mbyllin sytë dhe të dëgjojnë tregimin të cilin do ta përgatitni, e që ka të bëjë me një udhëtim në një ishull.

Tregimi duhet të ketë në përmbajtje jetën në ishull, ushqimin, gjumin, argëtimin, miqtë, dhe përjetimin e ndjenjave.

**Ju bëni**

Në këtë pjesë të orës, nxënëset/it do të shkruajnë sipas imagjinatës së drejtuar për një jetë në ishull me të gjitha specifikat, si: uji, kasollja, higjiena, ushqimi, gjahu dhe sfidat e ndryshme.

**Ju bëni**

Disa nga këto shkrime lexohen dhe diskutohen në klasë.

Njësia mësimore: <b>Jeta e re në ishull</b>
Ora e dytë: Fjalori
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Lexon tekstin,</li> <li>2. Identifikon fjalët e panjohura në tekst,</li> <li>3. Gjen kuptimin e fjalëve të panjohura.</li> </ol>
<b>Unë bëj/Ne bëjmë</b>
Bëhet një përsëritje e orës së kaluar rreth shkrimit të esesë dhe kalohet në pjesën tjetër, ku nxënëset/it informohet për veprimtarinë e radhës.
<b>Ne bëjmë</b>
<p>Udhëzohen nxënëset/it të lexojnë në heshtje tekstin “Jeta e re në ishull”.</p> <p>Është mirë që të caktohet një kohë për lexim.</p> <p>Pasi të lexohet teksti, nxënëset/it duhet ta bëjnë një përshkrim të tij.</p>
<b>Ju bëni</b>
<p>Analiza e fjalëve të panjohura duhet të fillojë me identifikimin e tyre, diskutimin në klasë, dhe, në fund, plotësimin e katër shtyllave të para të tabelës së fjalorit.</p> <p>Udhëzoni nxënëset/it që, për ta njohur vetë kuptimin e fjalës në kontekstin e fjalisë, teksti duhet të rilexohet sipas nevojës.</p>

Njësia mësimore: <b>Jeta e re në ishull</b>
Ora e tretë: Përdor pesë shqisat
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: 1. Analizon ngjarjen në disa aspekte: pamja, tingulli, aroma.
<b>Unë bëj/Ne bëjmë</b>
Paraprakisht, bëhet një lojë e thjeshtë me nxënëset/it duke i përdorur shqisat. Udhëzohen nxënëset/it që sapo ta dëgjojnë fjalën të prekin atë pjesë të fytyrës. Për shembull kur mësuesja/i thotë: Aroma – nxënëset/it prekin hundën. Shija – nxënëset/it prekin gojën. Shikimi – nxënëset/it prekin sytë etj.
<b>Ju bëni</b>
Udhëzohen nxënëset/it të punojnë sipas kërkesave në detyrë. Ata shfrytëzojnë imagjinatën dhe përmbajtjen e tekstit për të plotësuar kërkesat në libër.
<b>Ne bëjmë</b>
Detyrat e plotësuara nga nxënëset/it lexohen dhe diskutohen me njëri-tjetrin.

Njësia mësimore: **Jeta e re në ishull**

Ora e katërt: Kreativiteti

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Paraqet në mënyrë vizuale ngjarjen.

**Ne bëjmë**

Me nxënës bisedojmë për përmbajtjen e tekstit “Jeta e re në ishull”.  
Kujtojmë natyrën, ujin, ngjyrat, të gjitha specifikat etj.

**Ju bëni**

Nxënëset/it plotësojnë vizatimin me hartën e ngjarjes nga teksti.  
Ata përdorin mjete të ndryshme për ta realizuar vizatimin.

**Ne bëjmë**

Vizatimet e nxënësve ekspozohen dhe prezantohen duke krijuar bashkëbisedim me njëritjetrin.



Njësia mësimore: <b>Jeta e re në ishull</b>
Ora e pestë: Argëtohu
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: 1. Realizon aktivitete kreative dhe argëtuese bazuar në temën e tekstit.
<b>Ne bëjmë</b>
Nxënëset/it informohen për mënyrën e lojës në grupe, sipas kritereve të dhëna në libër.
<b>Ju bëni</b>
Në këtë pjesë të orës nxënësve u krijohet një ambient i përshtatshëm loje, me ç’rast janë përgatitur materiale dhe mjete të ndryshme pune, si: valixhe, ushqime, barëra, rroba, mjete pune, vegla peshkimi, mjete higjienike etj.; të gjitha këto mjete mund të shkruhen në fleta, sipas këtij modeli, p.sh.: Rroba – 10 kg. Ushqimi – 8 kg etj.
<b>Ne bëjmë</b>
Kjo pjesë e orës duhet të ketë kohë më shumë, për të prezantuar grupet se çka kanë përzgjedhur të marrin me vete, si dhe ta arsyetojnë atë përzgjedhje në raport me mënyrën se si do të jetojnë për një muaj në ishull.

Njësia mësimore: **Pranvera**

Ora e parë: Shfrytëzo njohuritë paraprake

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  
1. Tregon ndryshimet në mes të dialekteve.

**Unë bëj**

Para nxënësve lexohen dy vjersha apo tekste të shkurtra në dialekte të ndryshme. Nga nxënëset/it kërkohet të diskutojnë rreth këtyre pyetjeve:

- Cili ishte ndryshimi në mes të teksteve të lexuara?
- Çfarë kishin të ngjashme? Etj.

**Ju bëni**

Udhëzohen nxënëset/it të plotësojnë njohuritë sipas kërkesave të parashtruara. Nxënësve u jepet kohë e mjaftueshme për të punuar. Gjatë punës, nxënëset/it vëzhgohen dhe ndihmohen, sipas nevojës.

**Ju bëni**

Disa nga këto shkrime lexohen dhe diskutohen në klasë.

Njësia mësimore: **Pranvera**

Ora e dytë: Fjalori

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Lexon poezinë,
2. Identifikon fjalët e panjohura,
3. Gjen kuptimin e fjalëve të panjohura.

**Unë bëj/Ne bëjmë**

Kërkoet nga nxënësit të shkruajnë për çdo shkronjë fjalë të stinës së pranverës, sipas këtij modeli:

P - ëllumb

R

A

N

V

R

A

**Ne bëjmë**

Udhëzohen nxënëset/it të lexojnë në heshtje tekstin “Pranvera”.

Është mirë që të caktohet një kohë për lexim.

Pasi të lexohet teksti, nxënëset/it duhet të krijojnë një përshkrim për të.

**Ju bëni**

Analiza e fjalëve të panjohura duhet të fillojë me identifikimin e tyre, diskutimin në klasë, dhe, në fund, plotësimin e katër shtyllave të para të tabelës së fjalorit.

Udhëzoni nxënëset/it që, për ta njohur vetë kuptimin e fjalës në kontekstin e fjalisë, teksti duhet të rilexohet sipas nevojës.

Njësia mësimore: **Pranvera**

Ora e tretë: Lexo dhe përgjigju

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Përgjigjet në pyetje rreth tekstit.

**Unë bëj/Ne bëjmë**

Udhëzohen nxënëset/it se si të punojnë në këtë projekt mësimi.  
Puna e nxënësve mund të bëhet në dyshe, duke bashkëpunuar.

**Ju bëni**

Krijohet klima e përshtatshme për të punuar dhe nxënëset/it vazhdojnë veprimtarinë e tyre, sipas kërkesave të dhëna.  
Gjatë punës në dyshe, nxënëset/it ndihmohen sipas nevojës.

**Ne bëjmë**

Lexohen shkrimet e nxënësve, jepen shpjegime dhe argumente rreth përgjigjeve, si dhe nxitet debat në klasë.  
Korrigjohen gabimet eventuale dhe vlerësohen nga mësuesja/i.

Njësia mësimore: <b>Pranvera</b>
Ora e katërt: Shkruaj
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: 1. Shkruan poezinë në gjuhën standarde.
<b>Ne bëjmë</b>
Së bashku me nxënës, bëhet një përsëritje duke rikujtuar dialektet.
<b>Ju bëni</b>
Udhëzohen nxënëset/it të punojnë sipas kërkesave në detyrë. Ata do të mundohen ta shkruajnë vjershën sipas gjuhës standarde. Nxënëset/it punojnë të pavarur dhe pa ndihmën e mësueses/it.
<b>Ne bëjmë</b>
Vjersha lexohet nga nxënëset/it duke ngjallë diskutimin në klasë, derisa bëhet edhe korrigjimi i saj.  Kjo punë e nxënësve vlerësohet nga mësuesja/i.

Njësia mësimore: **Aventurat e Tom Sojerit**

Ora e parë: Shfrytëzo njohuritë paraprake

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Përshkruan personazhin, Tom Sojeri.

**Unë bëj**

Nxënëset/it përgatiten për të shikuar filmin e Tom Sojerit.

Po ashtu, përcaktohen pjesët e filmit që do t'i shikojnë.

Krijohet një klimë e përshtatshme.

**Ju bëni**

Udhëzohen nxënëset/it që të shkruajnë disa fjali për personazhin Tom Sojeri. Shkrimet e nxënësve lexohen nga nxënësit. Përshkrimet e ndryshme ngjallin diskutimin në klasë.

**Ju bëni**

Në këtë pjesë të orës nxënëset/it do të shkruajnë disa pyetje për personazhin Tom Sojeri. Disa nga ato do të lexohen dhe, njëkohësisht, u lejohet nxënësve që të japin përgjigje të mundshme.

Njësia mësimore: **Aventurat e Tom Sojerit**

Ora e dytë: Fjalori

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Lexon tekstin,
2. Identifikon fjalët e panjohura,
3. Gjen kuptimin e fjalëve të panjohura.

**Unë bëj/Ne bëjmë**

Kërkohet nga nxënëset/it që të tregojnë se çfarë dinë për Tom Sojerin, sipas këtyre pyetjeve:

- Çfarë keni dëgjuar për Tom Sojerin?
- Çfarë aventura mendoni që do të bëjë Tomi? etj

**Ne bëjmë**

Udhëzohen nxënëset/it të lexojnë në heshtje tekstin “Aventurat e Tom Sojerit”.

Është mirë që të caktohet një kohë për lexim.

Pasi të lexohet teksti, nxënëset/it duhet të krijojnë një ide kryesore me një fjali të përgjithshme, në fillim ose afër fillimit të paragrafëve, në mënyrë që të detajohen faktet. Nxënëset/it vlerësohen për përshkrimin e tekstit.

**Ju bëni**

Analiza e fjalëve të panjohura duhet të fillojë me identifikimin e tyre, diskutimin në klasë, dhe, në fund, plotësimin e katër shtyllave të para të tabelës së fjalorit.

Udhëzoni nxënëset/it që, për ta njohur vetë kuptimin e fjalës në kontekstin e fjalisë, teksti duhet të rilexohet sipas nevojës.

Njësia mësimore: **Aventurat e Tom Sojerit**

Ora e tretë: Intervista

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Formulon pyetje për intervistë.

**Unë bëj/Ne bëjmë**

Bashkëbisedohet me nxënës se çfarë dinë për intervistën, se ku e kanë parë apo kanë dëgjuar për të.

Disa pyetje të mundshme:

- Kur keni dëgjuar për herë të fundit një intervistë?
- Çfarë mbani në mend gjatë asaj bisede?
- Cilat nga pyetjet u kanë bërë përshtypje?

**Ju bëni**

Së bashku më nxënës rikujtojmë llojet e ndryshme të pyetjeve dhe mënyrën se si shtrohen ato.

Nxënëset/it udhëzohen të punojnë në projektin e tyre me titull *Intervista*.

Shkruaj disa pyetje për intervistën me personazhin e tekstit, Tomi.

**Ne bëjmë**

Disa pyetjet të shkruara nga nxënëset/it lexohet dhe komentohen, duke i arsyetuar ato.



Njësia mësimore: **Aventurat e Tom Sojerit**

Ora e katërt: Planifiko një festë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

1. Planifikon një festë në bazë të imagjinatës dhe ngjarjes së lexuar.

**Unë bëj**

Planifikohet të shtrohen pyetje për nxënëset/it, të cilat ndërlidhen me festa të ndryshme.

Dy nga pyetjet e mundshme:

- Si e organizoni një festë?
- Kush merr pjesë në organizim? Etj.

**Ju bëni**

Udhëzohen nxënëset/it të punojnë sipas kërkesave në detyrë.

Detyra mund të punohet edhe në grupe, duke i ndarë përgjegjësitë për secilin nxënës.

Gjatë punës, nxënëset/it vëzhgohen dhe ndihmohen sipas nevojës.

**Ne bëjmë**

Nxënëset/it, në grupe, prezantojnë punën e tyre.

Gjatë prezantimit mund të ketë pyetje që nxisin bashkëbisedimin në mes tyre.